

AKT THEMELIMI

I

“ATHENS MEDICA ALBANIA” sh.a

(Sistemi me një Nivel)

Neni 1 - Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, më 25/04/2025 (dymijë e njëzet e pesë) Virgilia Capital sh.p.k, regjistruar në QKB me NUIS M51616019M, **me adresë** në Rruga Skënderbej, Pall.8, Shkalla 1, K.1, Tiranë, përfaqësuar nga administratori Afrim Yzeiraj, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rr. “Sami Frashëri”, Nd.Pall.17, H.0, Ap.83, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me numër Nr.033994657 dhe Nr.personal H10515332P, me vendimin Nr.2 të Asmablesë së Ortakëve të shoqërisë Virgilia Capital sh.p.k, krijohet një shoqëri aksionare me emrin: **Athens Medica Albania sh.a**
- 1.2 **Shoqëria është emërtuar Athens Medica Albania sh.a (në vijim referuar si “Shoqëria”)** shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit no. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar (“referuar këtu e më poshtë si “**Ligji Tregtar**”).
- 1.3 Shoqëria ka vulën zyrtare dhe logon e saj.

Neni 2 – Selia Ligjore

- 2.1 Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: **Athens Medica Albania, Rruga e Elbasanit, Nd.2, K.2 & 3, Tiranë, Shqipëri.**
- 2.2 Shoqëria mund të hapë apo të mbyllë filiale, degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.
- 2.3 Në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Shoqërisë dhe aksionarëve, adresa për shkak të detyrës të çdo aksionari, do të jetë adresa që përcaktohet në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë. Në rast ndryshimi të kësaj adrese, aksionari përkatës do të njoftojë menjëherë me shkrim Shoqërinë dhe ndryshimi do të pasqyrohet në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë.

Neni 3 – Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria është krijuar për një afat të pacaktuar.

KREU II OBJEKTI

Neni 4 - Objekti

- 4.1 Objekti i Shoqërisë, do të përfshijë veprimtarinë në fushën e shëndetësisë, por, nuk kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:
 - Krijimin dhe administrimin e një klinike mjekësore të specializuar në diagnostikimin, trajtimin dhe menaxhimin e sëmundjes së diabetit dhe komplikacioneve të lidhura me të;

- Ofrimin e shërbimeve mjekësore të përgjithshme dhe të specializuara në fushën e endokrinologjisë, dietologjisë, kardiologjisë, neurologjisë, oftalmologjisë dhe shërbimeve të tjera mbështetëse;
- Realizimin e analizave laboratorike dhe shërbimeve diagnostike moderne;
- Hartimin dhe zbatimin e programeve të parandalimit dhe edukimit shëndetësor mbi diabetin dhe sëmundjet metabolike;
- Promovimin e stilit të shëndetshëm të jetesës dhe ofrimin e këshillimit nutricional dhe psikologjik për pacientët kronikë;
- Bashkëpunimin me institucione publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare, në funksion të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore;
- Organizimin e trajnimeve, konferencave, studimeve dhe projekteve kërkimore në fushën e diabetologjisë dhe shëndetit publik;
- Importimin dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të pajisjeve mjekësore, mjeteve diagnostike dhe medikamenteve të autorizuara për trajtimin e sëmundjeve kronike.

4.2 Me qëllim përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria gjithashtu, mund të:

- a) kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si edhe aktivitete tregtare, financiare, qera apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë;
- b) blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj; të marrë kredi/hua nga institucione financiare të licensuara në Shqipëri apo jashtë saj; dhe
- c) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk ndalohet nga ligji i zbatueshëm.

Neni 5 – Kapitali aksionar

5.1 Kapitali aksionar i nënshkruar i Shoqërisë është 10,000,000.00 (dhjetë milionë) Lekë, i ndarë në (dhjetë mijë aksione) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1000 (një mijë) Lekë secili.

5.2 Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga Aksionarët që zotërojnë aksionet e kapitalit të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit aksionar me anë të emetimit të aksioneve të reja, zmadhimit të kufizuar të kapitalit aksionar, zmadhimit të autorizuar të kapitalit aksionar, kalimit në kapitalin bazë të rezervave të disponueshme dhe të fitimeve të pashpërndara, emetimit të obligacioneve të konvertueshme dhe rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

5.3 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin aksionar të Shoqërisë nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit aksionar, apo anulimit të aksioneve por në asnjë rast kapitali aksionar nuk mund të jetë më i vogël se kapitali i regjistruar i shoqërisë.

Neni 6 – Aksionet

6.1 Aksionet janë të zakonshme.



- 6.2 Akti i emetimit të aksioneve hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe ky akt përmban të dhënat dhe duhet të jetë në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin e zbatueshëm.
- 6.3 Çdo aksion jep të drejtën e një vote.
- 6.4 Administratori i Shoqërisë harton dhe mban regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë në selinë e regjistruar të Shoqërisë i cili duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin apo emrin e shoqërisë, numrin e aksioneve, vlerën nominale të aksionit, adresën për shkak të detyrës apo adresën zyrtare të aksionarit.

Neni 7 – Transferimi i Aksioneve

- 7.1 Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen lirisht tek palë të treta, tërësisht apo pjesërisht, nga secili prej aksionarëve të Shoqërisë, pa qene i nevojshëm njoftimi, apo mbledhja e aksionarëve.
- 7.2 Çdo transferim i së drejtës së pronësisë lidhur me aksionet e Shoqërisë si edhe krijimi apo transferimi i çdo të drejte tjetër lidhur me këto do të regjistrohet në regjistrin e aksionarëve. Transferuesi do të njoftojë me shkrim Administratorin e Shoqërisë në lidhje me transferimin në ditën efektive të këtij transferimi.

Neni 8 – Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme;
- 2) Këshilli i Administrimit;
- 3) Administratori/ët; dhe
- 4) Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar.

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme

- 9.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e cila përbëhet nga Aksionarët e Shoqërisë. Organizimi, detyrat dhe kompetencat e këtij organi parashikohen në statutin e shoqërisë.

Neni 10 – Këshilli i Administrimit

- 10.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë në përputhje me nenin 145 të Ligjit Tregtar. Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit janë:
1. **Afrim Yzeiraj, Kryetar i Këshillit të Administrimit**, shtetas shqiptar me nr.id H10515332P, banues në Tiranë
 2. **Diamant Yzeiraj, Anëtar**, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës me nr.personal J31112050U
 3. **Eva Rama, Anëtare**, shtetase shqiptare me nr.id H66122123V
- 10.2 Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërohen për një afat prej 3 (tre) vjetësh, duke nisur nga data 25.04.2025 deri në 24.04.2028 dhe mund të ri-zgjidhen. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo moment Anëtarët e Këshillit të Administrimit.



- 10.3 Asambleja e Përgjithshme emëron Kryetarin e Këshillit të Administrimit midis anëtarëve të tij i cili ka gjithashtu të drejtën e një vote shtesë.
- 10.4 Administratori i Shoqërisë emërohet me shumicë të thjeshtë nga anëtarët e Këshillit të Administrimit.
- 10.5 Organizimi, detyrat dhe kompetencat e këtij organi parashikohen në statutin e shoqërisë.

Neni 11 – Administratori Kompetencat e Administratorit të Shoqërisë

- 11.1 Administratori (“**Administratorët e Shoqërisë**”, “**Administrator/ët**”) është person fizik, i cili mund të jetë ose jo anëtar i Këshillit të Administrimit, dhe propozohet dhe emërohet nga Këshilli i Administrimit, në përputhje me Nenin 158 të Ligjit Tregtar. Këshilli i Administrimit, apo aksionarët nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme, dhe me diskrecionin e tyre të plotë mund të shkarkojnë në çdo kohë Administratorin/ët për çfarëdolloj shkak që këto e quajnë të arsyeshëm.
- 11.2 Organizimi, detyrat dhe kompetencat e këtij organi parashikohen në statutin e shoqërisë

Neni 12 – Eksperti/t Kontabël të Autorizuar

- 12.1 Kontrolli i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga një apo më shumë ekspertë kontabël të autorizuar të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një afat të caktuar.
- 12.2 Emërohet në detyrën e ekspertit z.**Shkëlzen Margjeka**, shtetas shqiptar, mbajtës i kartës së identitetit me nr.personal H00122113G me Nr.Licence profesionale 178, dt.15.10.2008, dhe NUIS K82223008A, me afat nga data 25.04.2025 – 24.04.2028

Neni 13 – Viti Financiar

- 13.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më datë 31 dhjetor të çdo viti.
- 13.2 Viti i parër fillon me datën e regjistrimit të kësaj shoqërie

Neni 14 – Ligji i zbatueshëm dhe Juridiksioni

- 14.1 Ky Statut rregullohet nga ligji Shqiptar në fuqi dhe çdo mosmarrëveshje që lind nga dhe në lidhje me këtë Statut do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 14.2 Çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht në këtë Statut dhe në çdo marrëveshjen aksionarësh do të rregullohet nga Ligji Shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

Aksionari Themelues

Virgilia Capital sh.p.k

Administrator
Afrim Yzorec

VIRGILIA CAPITAL
Sh.p.k.
NUIS: M51616019M
TIRANA ALBANIA